

## Njoftim për vend vakant pune

Shoqëria “Albpetrol SH.A”, shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin e punës **Drejtor në Drejtorinë e Prokurimeve** një kandidat profesionist, i cili duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Aftësitë e kërkuara:

<b>Arsimimi</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të ketë kryer arsimin e lartë në Fakultetin Ekonomik ose Fakultetin e Drejtësisë.</li></ul>
<b>Eksperiencë pune</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Preferohet të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në profesion.</li><li>• Të paraqesë Letra Reference nga punëdhënësit e mëparshëm.</li></ul>
<b>Cilësitë</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre;</li><li>• Të zotërojë gjuhën angleze;</li><li>• Aftësi për të kryer shumë detyra, për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet;</li><li>• Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikim me gojë/shkrim, të jetë i përshtatshëm për të punuar në grup, si dhe i hapur ndaj sfidave të ndryshme që mund të lindin nga procesi i punës;</li><li>• Aftësi për të vendosur objektiva dhe për të marrë vendime;</li><li>• Nivel i lartë integriteti, besueshmërie dhe orientimi të rezultateve;</li><li>• Njohuri të mira të programeve kompjuterike dhe sistemeve që lidhen me profesionin</li></ul>

Kandidatët që plotësojnë kushtet sipas përshkrimit të mësipërm dhe që dëshirojnë të aplikojnë, duhet të dërgojnë kërkesën e tyre, së bashku me CV; Fotokopje e Diplomës; Fotokopje e librezës së punës, në adresën elektronike [bni@albpetrol.al](mailto:bni@albpetrol.al) ose ta dorëzojnë atë fizikisht në zyrën e Burimeve Njerëzore në Albpetrol sh.a.

Kandidati duhet të specifikojnë qartë në titullin e emailit pozicionin e punës për të cilin po aplikon.

Aplikimet pranohen deri në datën 08 Qershor 2020, ora 16:00.